



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Nr. 490 /4 Prot

Datë 24/02 /2020

Lënda: Disa ndryshime dhe shtesa, në dokumentin me Nr.6097/7 prot, datë 24.10.2014 “Procedurat, formati shpjegues dhe vlerësimi i aplikimit për pajisjen me akt miratimi të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues, formati i vërtetimit”

Në mbështetje të neneve 6/a/ç dhe 7/a të ligjit Nr.10 469 datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, me qëllim përmirësimin dhe qartësimin e të dhënave që lidhen me aplikimet për stacionet bazë , Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet , miratoi ndryshimet si më poshtë:

Në fund të pikës 1 të dokumentit shtohet ;

-Në rastet e aplikimeve të përbashkëta, të deklarohet në faqen e parë të studimit të raportit të vlerësimit të shpërndarjes së fushës së rrezatimit elektromagnetik për secilën kompani nëse ka apo jo ndryshime.

-Në çdo faqe të raportit të jetë e vendosur vula lidhëse e operatorit që kryen aplikimin.

Në pikën 2 të dokumentit “ Kërkesë për akt miratimi për veprimtarinë e burimeve të rrezatimeve jojonizuese” ndryshohet ;

-Termi një planimetri të zëvendësohet me “ disa planimetri (sa numri i operatorëve plus një planimetri më shumë që do mbetet në arkivin e ZMR). Këto planimetri duhet të përmbajnë të dhëna më të detajura të konstruksioneve të strukturave të site-it; konkretisht pozicionet e masteve dhe azimutet të emëtuara sipas numrave rendor ”.

-Pas termit “ Kordinatat gjeografike shtohet; koordinatat gjeografike të paraqiten në formën xx°(grade) xx.x '(minuta) xxx.xx " (sekonda)

-Përpara aplikimit për akt miratimi, operatorët të sigurojnë nëse ka hapësirë të mëtejshme për të shtuar frekuenca të reja në atë zonë, brenda limiteve rregullatore.

SEKRETARI
Rustem PACI

KRYETARI
Ogerta MANASTIRLIU